

8 dhjetor 2013

## NJOFTIM PËR MEDIA

### Ecja e personave me nevoja të veçanta për identifikimin e pengesave

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Sot në Prizren është realizuar ecja e personave me nevoja të veçanta për identifikimin e pengesave fizike, duke filluar nga rrethrotullimi në lagjen Bazhdarhane (afër memorialit të NATO-s) deri në sheshin Shadërvan. Pas identifikimit të këtyre pengesave, do të përgaditet harta e pengesave, e cila do t'i dërgohet qeverisë lokale të Prizrenit me kërkesën për veprime konkrete në eliminimin e këtyre pengesave.

Pas shumë fokus grupeve, debateve, analizave të bëra me personat me nevoja të veçanta në kuadër të projektit "Qyteti gjithëpërfshirës...", EC Ma Ndryshe bashkë me këtë grup të komunitetit kanë identifikuar pengesat fizike me të cilat ballafaqohen këta qytetarë në përditshmërinë e tyre. Identifikimi dhe hartëzimi i pengesave udhëhiqet dhe mbikëqyret nga Znj. Rozafa Basha, arkitekte (ligjëruese në Fakultetin e Arkitekturës, UP), e cila gjatë ecjes së sotme është asistuar nga stafi i projektit dhe organizatës, studentë të Arkitekturës dhe shoqëruesit e personave me nevoja të veçanta.

EC Ma Ndryshe së shpejti do të bëj publike hartën me pengesat fizike, e cila do t'i dërgohet qeverisë lokale të Prizrenit. Mbetemi me shpresë se autoritetet shtetërore dhe shoqëria do të dëshmojnë përkushtim në adresimin dhe zgjidhjen e problemeve me të cilat personat me nevoja të veçanta ballafaqohen në baza ditore.

Ju faleminderit për bashkëpunim.

Me respekt,  
Fjolla Gashi, koordinatore projekti  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraqët 5, 20000 Prizren  
Rr. Zeki Shulemaja 2, 10000 Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
[fjolla.gashi@ecmandryshe.org](mailto:fjolla.gashi@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771  
+377 44 351 537